



Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria -Vlada-Government

Programi i Qeverisë së Republikës së Kosovës 2017-2021

MINISTRIA E INOVACIONIT DHE NDËRMARRËSISË

Prishtinë, shtator 2017

MINISTRIA E INOVACIONIT DHE NDËRMARRËSISË

Potenciali i NVM-vë për rritjen e produktivitetit dhe krijimit të vendeve të punës është i lartë. Struktura aktuale e ekonomisë së Kosovës karakterizohet me pjesëmarrje mbi 90% të NVM. Me qëllim të arritjes së efekteve të shpejta në ekonomi planifikohet të reduktohen barrierat burokratike, lehtësim i qasjes në financa, lehtësim i procedura në sistemin gjyqësor, luftimin e ekonomisë joformale, si dhe luftimin e krimeve ekonomike dhe korrupsionit.

Synimi i Qeverisë është stimulimi i aktiviteteve inovative në Republikën e Kosovës të cilat do të jenë të lidhura ngushtë me ndërmarrësinë dhe me fushat e tjera të ekonomisë. **Zhvillimi i ndërmarrësisë dhe iniciativës private përmes inovacioneve dhe me fokus në zhvillimin e NVM-ve prodhuese dhe shërbyese**, është parakusht për rritje të punësimit, rritje të konkurrueshmërisë dhe rrjedhimisht rritje të sektorit privat. (veçanërisht të të **rinjve dhe grave**).

Politikat ekonomike do të orientojnë dhe përkrahin ndërmarrjet të kombinojnë njohuritë, kapacitetet, aftësitë dhe resurset (njohuri për prodhimin, aftësi dhe hapësira, njohuri në lidhje me tregun, sistem efikas të distribuimit, resurse të mjaftueshme financiare, etj.) për të zhvilluar konceptin e inovacionit brenda ndërmarrjes.

Lista e objektivave të Ministrisë së Inovacionit dhe Ndërmarrësisë për Programin e Qeverisë 2017-2021:

1. *Promovimi i inovacionit sipas sektorëve të ekonomisë në shërbim të rritjes ekonomike dhe zhvillimit;*
2. *Krijimin i mekanizmave institucional koordinues në mes të shkencës, sektorit privat dhe politikë-bërjes;*
3. *Zhvillimi i ndërmarrësisë përmes programeve të trajnimit/konsulencës;*
4. *Konsolidimi i fondit për TIK dhe krijimi i fondeve për përkrahje të sektorëve zhvillimor (me fokus tek gratë dhe të rinjtë);*
5. *Mbështetja e zhvillimit të NVM-ve për ballafaqim me presion konkurrues në rajon, BE dhe tregjet e tjera.*

Qeveria përmes skemave financiare dhe jo financiare si dhe përmes trajnimeve do të përkrahë: (1) produktet e reja; (2) metodat e reja të prodhimit; (3) metodat e reja të furnizimit; (4) shtrirjen në tregjet e reja; si dhe (5) metodat e reja të organizimit të biznesit.

Përshkrimi i objektivave të Ministrisë së Inovacionit dhe Ndërmarrësisë

1. PROMOVIMI I INOVACIONIT SIPAS SEKTORËVE TË EKONOMISË NË SHËRBIM TË RRRITJES EKONOMIKE DHE ZHVILLIMIT

Qeveria do të krijoj mekanizëm të rregullt të komunikimit për bashkëpunim të ngushtë me komunitetin e TIK dhe ndërmarrësit si dhe me përfaqësitë diplomatike të Kosovës jashtë vendit me qëllim të krijimit të lidhjeve funksionale të ndërmarrësve me institucionet si dhe me gjigandët e teknologjisë, sipas konceptit Ambasadori Digjital.

Qeveria do të institucionalizoj konceptin e inovacionit përmes organizimit të rregullt të **Javës së Inovacionit**, ku do të ftohen kompanitë inovative vendore dhe ndërkombëtare që të shkëmbejnë përvojat në këtë fushë. Themelimi i Qendrave Rajonale të Inovacionit, do mundësojnë komunikim të drejtpërdrejtë dhe qasje pro-aktive drejt zhvillimit të ndërmarrjeve inovative.

Inovacionet do të përkrahen edhe sipas sektorëve përkatësisht në sektorin e energjisë me qëllim të uljes së konsumit të energjisë me anë të masave për eficiencë të energjisë. Në sektorin e bujqësisë do të përkrahen ndërmarrjet që aplikojnë sistemet e avancuara në bujqësi për rritje të produktivitetit, konkurrueshmërisë dhe diversifikimit. Po ashtu i njëjti sistem do të aplikohet edhe në sektorin e shëndetësisë, në kuptim të identifikimit të zgjidhjeve inovative për të ofruar shërbime efikase shëndetësore.

Zhvillimi i PPP-ve për investimet në inovacione dhe konsolidimi i infrastrukturës ligjore për “angel investors” janë veprime institucionale që do të adresojnë nevojat e këtij sektori brenda një afati optimal kohor. Krijimi dhe konsolidimi i Këshillit për inovacion dhe ndërmarrësi do mundësojë realizimin e konceptit integral të inovacionit dhe ndërmarrësisë.

2. KRIJIMI I MEKANIZMAVE INSTITUCIONAL KOORDINUES NË MES TË SHKENCËS, SEKTORIT PRIVAT DHE POLITIKË-BËRJES

Implementimi i programit nacional për zhvillimin e aftësive dhe shkathtësive profesionale do të identifikojë profesionet e nevojshme për të mbështetur ekonominë. Ky program do të implementohet nëpërmjet **Agjencisë së zhvillimit të aftësive profesionale**. Ky agjencion do të mbështesë arsimin e vazhdueshëm gjatë gjithë jetës, në mënyrë që ndërmarrjet t’u përgjigjen nevojave të tregut të punës me ekspertizë dhe kompetencë profesionale.

Me qëllim të adresimit të këtij objekti do të zbatohen këto veprime: (i) Zhvillimi i akselatorëve si inkubator për inovacione për sektor të veçantë, (ii) Ndërlidhja e dijes me inovacione, (iii) Zgjerimi i infrastrukturës përkatëse për rritjet dhe shërbimet e TIK-ut për zhvillimin socio-ekonomik, (iv) Organizimi i komunitetit të biznesit pranë qendrave të inovacionit, (v) Nxitja e bashkëpunimit biznes-akademi dhe mbështetja në promovimin e teknologjisë dhe inovacionit me qëllim të rritjes së konkurrueshmërisë së kompanive në Kosovë, (vi) Përmirësimin e kornizës

ligjore për inovacione dhe transferim të dijes dhe teknologjisë dhe për financimin e veprimtarisë kërkimore shkencore, (vii) Përgatitja e doracakut rreth inovacioneve/ ndërmarrësisë, zhvillimit të tyre dhe ndikimit të tyre në veprimtaritë ekonomike dhe pronën intelektuale, (viii) Tërheqja e fondeve (fund-raising) për realizimin dhe zbatimin në praktikë sa më të plotë të inovacioneve në bashkëpunim me sektorin privat të ekonomisë, (ix) Rritja e buxhetit për përkrahje të aktiviteteve për hulumtim dhe zhvillim në akademi dhe sektorin privat.

3. ZHVILLIMI I NDËRMARRËSISË PËRMES PROGRAMEVE TË TRAJNIMIT/KONSULENCËS

Qeveria do të institucionalizoj programe trajnimi dhe do përkrahë financiarisht praktikantët që hyjnë në tregun e punës pas përfundimit të shkollimit. Në kuadër të kësaj objekte, planifikohet të ofrohen trajnime dhe të përkrahen certifikime ndërkombëtare për sektorët ku ekonomia ka përparësi konkurruese.

NVM-të do përkrahen përmes programeve të veçanta për zhvillim të konceptit të marketingut tek sektorët me potencial eksporti. Programet e tjera do të fokusohen në standardizim, konformitet, si dhe kërkesat e tjera që dalin nga procesi i anëtarësimit në Bashkimin Evropian, si dhe në asistim të ndërmarrjeve për konkurrim me projekte konkrete në fondet përkatëse të Komisionit Evropian për inovacion dhe ndërmarrësi.

Ky objektivi do të implementohet përmes: (i) Zhvillimi i aftësive ndërmarrëse si dhe përkrahjen për të mundësuar qasjen në kapital, (ii) Trajnimi i të rinjve të diplomuar dhe grave për ballafaqim me kërkesat e tregut të punës.

4. KONSOLIDIMIT I FONDIT PËR TIK DHE KRIJIMI I FONDEVE PËR PËRKRAHJE TË SEKTORËVE ZHVILLIMOR (ME FOKUS TEK GRATË DHE TË RINJTË)

Fondit për TIK të do mundësojë fokusimin në Start-up, mbështetjen e bizneseve ekzistuese dhe nxitjen e investimeve të reja. Fondi do të ketë për qëllim lehtësimin e qasjes në financa për bizneset e sektorit të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit (TIK) duke stimuluar në këtë mënyrë financimin e investimeve inovative me qëllim të nxitjes së investimeve private në sektorin e TIK-ut në Kosovë dhe rrjedhimisht krijimin e vendeve të reja të punës, rritjen e produktivitetit si dhe rritjen e eksportit.

Qeveria do të punoj në drejtim të krijimit të modeleve alternative të financimit të bizneseve të reja, si dhe duke investuar në krijimin e aftësive të domosdoshme për të konkurruar në sektorin privat. Fokusi themelor do të jetë në mikro-ndërmarrje të cilat do të krijohen në qendrat rajonale të biznesit. Fondi i ndërmarrësisë, së bashku me atë të TIK-ut, do të bashkërendohet me donatorët në Kosovë dhe do të menaxhohet sipas praktikave më të mira ndërkombëtare dhe në bashkëpunim me donatorët.

Me qëllim të rritjes së punësimit tek kategoria e grave dhe të të rinjve, planifikohet të ofrohen stimuj fiskal dhe jo-fiskal për NVM-të që **punësojnë gra dhe të rinj**.

5. MBËSHTETJA E ZHVILLIMIT TË NVM-VE PËR BALLAFAQIM ME PRESION KONKURRUES NË RAJON, BE DHE TREGJET E TJERA

Me qëllim të realizimit të këtij objekti, Qeveria do të vendosë bashkëpunim të qëndrueshëm mes Institucioneve Publike dhe Private të Arsimit Universitar, reformim i sistemit dhe financim i programeve që zhvillojnë ndërmarrësinë.

Qeveria do të garantoj mbrojtjen dhe avokimin e interesave të ndërmarrësisë kosovare, duke krijuar ambient të favorshëm të biznesit dhe investimeve, përmes fuqizimit të rolit dhe aktiviteteve të Këshillit Kombëtar për Zhvillim Ekonomik të Kosovës - KKZHE.

Qeveria do të zgjerojë përkrahjen për Iniciativat e të rinjve, duke hapur **Qendra rajonale të Inovacionit dhe Inkubator Biznesi**. Gjithashtu do të ngritën skema të **financimit të projekteve dhe start up-eve**, nëpërmjet investimeve në ekuitet apo duke dhënë grante. Përkrahja financiare nuk do të jetë e limituar mirëpo do të investohet sipas kërkesës dhe nevojës.

Po ashtu, nxitja e punësimit në sektorin e TIK-ut do të realizohet edhe përmes lehtësirave tatimore. Në këtë drejtim do të lirohen nga tatimi në fitim për investimet në fushën e hulumtimit dhe zhvillimit dhe inovacionit në sektorët e ekonomisë.

Do të aplikohet pushimi tatimor për NVM-të për investime të reja që rezultojnë në krijim të vendeve të reja të punës. Për NVM-të e orientuara në shërbime do të zvogëlohet TVSH nga 18% në 6%.

Ky objektivi do të implementohet përmes këtyre masave: (i) Vënien në fuqi të programeve dhe instrumenteve të eksportit për t'iu ndihmuar NVM-ve që të integrohen në zinxhirët e vlerave globale për të mbështetur ndërkombëtarizimin e tyre (marketing, standardizim, produktivitet, digjitalizim, etj.), (ii) Miratimin e masave për të thelluar dhe zgjeruar ndërmjetësimin financiar, me qëllim të rritjes së qasjes në financa për NVM-të, (iii) Zhvillimin e NVM-ve në Kosovë përmes zhvillimit grupor në sektorët prioritarë të politikës industriale të Kosovës.